

QYTETARËT PËR NDRYSHIM

KORRIK - SHTATOR 2022 // CIVICAMOBILITAS.MK

BULETIN NR.14



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



E KEMI PËR OBLIGIM TË KRIJOJMË AKTIVISTË TË RI QYTETAR

Një pjesë e rezultateve të anketës së fundit të MCMS “Përgjegjësia shoqërore e qytetarëve” më tingëllon inkurajuese, veçanërisht pjesa që tregon se ka rritje të anëtarësimit në organizatat e shoqërisë civile. Të dhënat tregojnë se më shumë se 1/3 e qytetarëve janë shprehur se janë anëtarë të ndonjë organizate. Prej tyre, më shumë janë aktivë (20.7%) sesa joaktivë (16.2%). Dikush do të thoshte se nuk është një numër i konsiderueshëm, por krahasuar me situatën e vitit 2010, kur anëtarësimi i përgjithshëm ishte 24.6%, dhe aktivët (9.5%) ishin më pak se joaktivët (15.1%), ndryshimi është i dukshëm.

Si organizata qytetare, ne besojmë se ajo që bëjmë dhe rezultatet që i kemi arritur kanë ndikuar në vendimin e qytetarëve për t’u përfshirë në punën tonë. Ndoshta qytetarët nuk kanë zgjedhur një organizatë ekzistuese, ndoshta në bazë të interesave të tyre kanë vendosur të themelojnë një shoqatë të re dhe kështu kanë mobilizuar bashkëqytetarët apo miqtë e tyre me synimin për të arritur ndryshimin e dëshiruar. Në këto shifra nuk përfshihen qytetarët që aktivizohen përmes nismave informale. Formalisht ose joformalisht, është e rëndësishme që në një farë mënyre ata vendosën të artikulojnë interesin e tyre për ndryshim.

Po pse aktivizmi qytetar dhe qytetarët aktivë janë kaq të rëndësishëm për ne? Ndoshta sepse ato janë një pjesë thelbësore e çdo ndryshimi për të cilin ne përpiqemi. Ata me përvojë thonë se bëhesh aktivist kur e kupton se askush nuk do ta bëjë nëse nuk e bën. Dhe për të arritur qëllimin, ata duhet të jenë optimistë, të

jenë të hapur për të mësuar dhe të kenë një vullnet të fortë për të kontribuar. Aktivizmi qytetar është punë serioze dhe kërkon shumë kohë dhe vullnet. Por ajo që është veçanërisht e rëndësishme të kuptohet është se aktivizmi nuk është diçka që ndodh vetëm në rrugë. Vërtet aty dëgjohet më shumë, por ndodh edhe në shtëpi, në zyrë, në kafe me miqtë dhe kudo ku kemi mundësi ta zhvendosim kusurin. Nuk duhet të shqetësohemi nëse në fillim jemi të paktë në numër. Lëvizjet që bënë ndryshim filluan edhe me disa individë që punuan me përkushtim dhe dinin të mobilizonin të tjerët për të ushtruar presion dhe për të bërë ndryshimin.

Tema e këtij numri të Qytetarët për ndryshim është aktivizmi apo angazhimi qytetar. E ndjekim përmes disa teksteve dhe fushave ku bashkëlloftëtarët tanë të sektorit duan të bëjnë një ndryshim, qoftë shëndeti, mjedisi, mbështetja e familjeve që jetojnë në varfëri, çështjet gjinore apo diçka tjetër. Gjithashtu, hidhini një sy artikujve në temat e tjera të revistës, pjesëmarrja qytetare, bashkëpunimi dhe mjedisi mundësues.

Në frymën e aktivizmit, mbani mend se aktivistë të ri qytetar duhet të krijojmë të gjithë. Këta janë ata që do të vazhdojnë luftën për gjërat për të cilat po luftojmë sot.

Lexim të këndshëm!

Gonce Jakovleska
Koordinator kombëtar i
Civika mobilitas për IKO

Falënderojmë: OJQ Infoqendra, RCS Spektar nga Kriva Pallanka, Fondacioni shkencor Spiroski, Rrethi i Grave, Shoqata “Changemakers” dhe Kostadin Karev, Ambasada e parë e fëmijëve në botë “Megjashi”, Angelcats, Shoqata maqedonase e kooperativave bujqësore (SHMKB), Instituti për politikat evropiane (IPE), Instituti për demokraci “Societas Civilis” (IDSCS), Qendra për komunikim qytetar (QKQ), Platforma për barazi gjinore, Platforma maqedonase kundër varfërisë, NEXUS-koncepti qytetar, “Mobiliteti” nga Velezi, “Ajnshtajni”, Maqedoni 2025, Antiko dhe BCSDN për mbështetjen dhe aksesin në informacion gjatë përgatitjes së teksteve për këtë numër. **Foto arkiva:** MCMS, Civika mobilitas, OJQ Infoqendra, Fondacioni shkencor Spiroski, Rrethi i Grave, Shoqata “Changemakers”, Ambasada e parë e fëmijëve në botë “Megjashi”, Angelcats, Shoqata maqedonase e kooperativave bujqësore (SHMKB), Instituti për politikat evropiane (IPE), Instituti për demokraci “Societas Civilis” (IDSCS), Qendra për komunikim qytetar (QKQ), Platforma për barazi gjinore, Platforma maqedonase kundër varfërisë, NEXUS-koncepti qytetar, “Mobiliteti” nga Velezi, “Ajnshtajni”, Maqedoni 2025 dhe Antiko

TEMA
**ANGAZHIMI
QYTETAR**

Seri e takimeve informative “Njoftoju me inspektorin tënd”



Qytetarë dhe përfaqësues të organizatave qytetare u takuan me shërbimet lokale inspektuese nga Struga, Sveti Nikoleja, Kumanova, Velezi dhe Kriva Pallanka. Gjatë ditëve informative, inspektorët komunalë, të cilët janë kyç për respektimin e rendit dhe ligjeve nëpër komuna, në fillim të korrikut i hapën dyert për qytetarët.

Qytetarët patën mundësinë të bisedojnë me inspektorët komunalë, të njihen me kompetencat e tyre, të ndajnë problemet me të cilat ballafaqohen, si dhe të informohen se si mund të raportojnë një problem dhe të kërkojnë inspektim. Nga ana tjetër, inspektorët patën mundësinë t'i qartësojnë kompetencat e tyre, fazat e procedurave dhe komunikimin me qytetarët, si dhe t'u përgjigjen pyetjeve specifike nga fushat komunale dhe ndërtimore, mjedisi jetësor dhe fusha të tjera me interes publik.

Konkluzioni kryesor i këtyre takimeve është se qytetarët duhet të bashkëpunojnë me shërbimet lokale të inspektimit dhe të bëjnë përpjekje të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve dhe sfidave në komunitetin lokal, në interes të shërbimeve më të mira dhe plotësimit të nevojave të të gjithëve.

Info ditët u mbajtën në disa komuna në kuadër të projektit “Shërbimet lokale inspektuese në interes të qytetarëve”, i cili zbatohet nga OJQ Infoqendra nga Shkupi me organizata partnere, Qendra e komunitete të Komunës së Strugës dhe Qendra rajonale për bashkëpunim “Spektri” nga Kriva Pallanka me përkrahje të programit Civica mobilitas.

Dhuro palcën kurrizore – dhuro jetë!

Fondacioni shkencor Spiroski (FSHS) organizoi katër aksione dhurimi ku pjesëmarrësit u inkurajuan të bëhen donatorë të mundshëm të palcës kurrizore dhe të jenë pjesë e Regjistrisë të donatorëve të palcës kurrizore (RDHP). Gjatë këtyre aksioneve, të punësuarit së bashku me vullnetarët e prezantuan mundësinë për inkuadrim në regjistrë, e shpjeguan funksionimin e tij dhe mundësinë e shpëtimit të jetës së dikujt.

Për promovimin e këtij misioni fisnik, Fondacioni organizoi aktivitete të pavarura ose iu bashkëngjiti eventeve të organizatave të tjera. Kështu, një nga aktivitetet dhuruese u organizua në plazhin “Orevçe” në Ohër, ndërsa një

tjetër ishte pjesë Krushevo trail çelinxh (Krushevo Trail Challenge) të organizuar nga Klubi orientues “Zlatovrv” nga Prilepi. Në këtë ngjarje ndërkombëtare sportive në natyrë, Fondacioni ishte mbështetës i garës së fëmijëve. Dy aksionet e tjera dhuruese u organizuan në “Ekipi A” të Qendrës për intervenim të hershëm dhe stimulim të fëmijëve dhe të rriturve në Shkup dhe gjatë Seminarit XXI për cilësi, kontroll, informatikë dhe mbrojtje në diagnostikimin laboratorik mjekësor të organizuar nga Asociacioni i laboratorëve të Maqedonisë në Ohër.

Fondacioni shkencor Spiroski përpaket të ndihmojë në kuptimin e transplantit të në vendin tonë si një trajtim

i disponueshëm për shpëtimin e jetës dhe të sigurojë një donator të përshtatshëm për numrin më të madh të mundshëm të pacientëve, kryesisht duke e vendosur, mirëmbajtur dhe zgjeruar regjistrin që përmban një numër të mjaftueshëm të donatorëve të tipit HLA. Regjistri i donatorëve të palcës kurrizore mundëson akses të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë në bazën

e donatorëve të palcës kurrizore të të gjithë qytetarëve brenda dhe jashtë vendit, ku zgjidhet individualisht nevoja për transplantim të palcës kurrizore. Vëmendje e veçantë i kushtohet eliminimit të barrierave financiare që mund të ndeshen nga pacientët që kërkojnë transplantim të palcës kurrizore.

ENGAGE 2022 – Hapësirë për aktivistët



Folës dhe aktivistë vendas dhe të huaj ishin pjesë e “ENGAGE 2022” të sivjetmë në Kurshumli An, ku u prezantuan histori personale frymëzuese se si të alarmojnë për problemet mjedisore, si është të raportosh nga lufta, si mund ta ndryshojnë mediat narrativin publikun për problemet sociale dhe ekzistenciale, por edhe se si të rinjtë mund të ndërtojnë një start-up të suksesshëm nga hobi i tyre.

Ajo që i lidhi të gjithë folësit ishte nevoja për aktivizim, përgjegjësi apo angazhim në një nivel tjetër në komunitet. Ana Çoloviq Lesoska nga “Eko-svest”, njëherit fituese e çmimit prestigjioz “Goldman”, tha se kanë filluar si grup entuziastësh me idenë për të shkundur shoqërinë, për të folur për çështjet mjedisore. Me kalimin e kohës, tha ajo, e kuptuan se nuk mjafton vetëm të jesh në rrugë, por duhet bërë presion edhe brenda institucioneve, duke punuar në të njëjtën kohë për eko-edukimin që në moshë të re.

Ajo që i lidh folësit e ENGAGE 2022 është nevoja për aktivizim, përgjegjësi apo angazhim në një nivel tjetër në komunitet.

Gazetarja Kristina Atovska, raportuese nga lufta në Ukrainë, foli për nevojën që gazetarët të angazhohen në monitorimin dhe prezantimin e situatave reale nga terreni.

“Gazetari është korrigjuesi i qeverisë dhe zëri i popullit. Dhe askush nuk është më i rëndësishëm për ata njerëz që zgjohen me një tank në oborr. Unë isha e vetmja gazetare e jona që isha aty, gjë që thotë shumë dhe është një kritikë e madhe për të gjithë vendin”, tha ajo, duke shtuar se raportimi i saj nga fronti kërkonte gatishmëri psikofizike për gjithçka që e priste në terren.

Për rolin e mediave ka folur edhe Besa Luçi, themeluese e organizatës së pavarur mediatike “Kosova 2.0”. Pas pavarësisë së Kosovës, mungoi një diskutim i vërtetë publik. Kështu, në vitin 2010, ata e themeluan “Kosova 2.0”, pasi

një numër i madh historish nga qytetarë të marginalizuar apo të shqetësuar kishin arritur vazhdimisht tek ata. Ajo mendon se është e rëndësishme që të ketë hapësirë që të rinjtë apo të marginalizuarit të publikojnë problemet e tyre dhe më pas kjo të reflektohet si diskutim në shoqëri.

Nevoja për diskutime publike u iniciua edhe nga Marko Mihailoviq, drejtor i “Pride Society”, koordinator i Europride që u mbajt në Beograd. “Nikoqirë të Europride janë qytetet e mëdha evropiane. Ne donim të tërhiqim vëmendjen te Beogradi dhe Ballkani Perëndimor për të vënë në dukje problemet me të cilat përballlet komuniteti LGBTI+ këtu dhe të bënim thirrje për zgjidhje. Ajo që ndodhi në Beograd nuk ishte paradë, por tregoi se sa i madh është stigmatizimi në këto hapësira. Në këto 5-6 muaj kemi përjetuar gjuhën e urrejtjes, mungesën e veprimit nga ana e institucioneve, kemi përjetuar shumë dezinformata, shumë dehumanizim”, tha ai.

Nikolla Vellkovski, duke folur për ndikimin dhe mundësitë e teknologjisë, tregoi historinë e suksesit të kompanisë së tij “Howitzer”. Fillimet janë në vitin 2020 gjatë koronës, por kjo nuk i pengoi ata të kapërcejnë të gjitha pengesat dhe të vazhdojnë të jenë ambasadorë të rinisë dhe sipërmarrësisë.

Në organizim të Radio MOF dhe Forumit arsimor rinor, “ENGAGE 2022” i siguroi hapësirë korit të parë gjithëpërfshirës të “Kolektiv Veternica” dhe “Trisomia 21”, ndërsa aktivisti dhe drejtuesi i emisionit “Unë jam Cako” – e lexoi poezinë e tij. Gjithashtu, publiku i edicionit të sivjetshëm mund të merrnin pjesë në disa nga punëtoritë për dizajnin e veshjeve, krijimin e byzylykëve dhe artin përmes stikerëve.

Gratë flasin dhe ndryshojnë - Takimi vjetor i Rrethit të Gruas

Nga 13 deri më 15 korrik në Strugë u mbajt takimi vjetor i Rrethit të Gruas, një grup prej 80 qytetaresh dhe aktivistesh nga 50 fshatra, vendbanime dhe organizata të grave nga 11 komuna dhe nga Shkupi. Grupi i është përkushtuar zbulimit, përdorimit dhe shpërndarjes së zërit të grave nga komunitetet dhe ndikimit kolektiv mbi punën dhe vendimet e autoriteteve lokale.

Gjatë takimit vjetor, pjesëmarrësit u rrjetëzuan dhe shkëmbyen përvoja nga aplikimi i një qasjeje në terren për fuqizimin e grave. Ata i ndanë qasjet specifike në fuqizimin

dhe organizimin e zërave të grave dhe avokimin e politikave të ndërgjegjshme gjinore për autoritetet lokale. Gjithashtu, gjatë takimit u vendosën bazat e strategjisë për Rrethin e Gruas.

Ky rreth përfaqëson një platformë për ndërtimin e aktivizmit të grave lokale përmes socializimit, shkëmbimit të përvojave dhe edukimit për pjesëmarrje qytetare në formësimin e politikave për një cilësi më të mirë të jetës për të gjithë në komunitetet lokale.



Për herë të parë në Gjevgjeli seleksionohen mbeturinat e biodegradueshme

Falë Shoqatës “Changemakers”, komuna e Gjevgjelisë do të fillojë me seleksionimin e mbeturinave shtëpiake të biodegradueshme, të cilat do të përpunohen në pleh të cilësisë së lartë. Projekti për trajtimin e qëndrueshëm të ushqimit dhe mjedisit është promovuar më 15 shtator në tribunën e mbajtur në Tregun e qytetit në Gjevgjeli.

Aktiviteti i parë përfshinte vendosjen e një kontejneri të shënuar për grumbullimin e mbetjeve të biodegradueshme në tregun e qytetit, si dhe shpërndarjen e kovave falas për përzgjedhjen e mbetjeve organike. Në këtë mënyrë, kalohet drejt trajtimit të qëndrueshëm të mbetjeve, duke reduktuar sasinë e mbetjeve që krijojmë çdo ditë, si dhe duke krijuar humus përmes procesit të kompostimit.

Nga Shoqata një kohë të gjatë flitet se humusi cilësor importohet me çmim që tejkalon 10 denarë për litër dhe se opsion shumë më i qëndrueshëm është prodhimi i tij në vend, me mundësi të shitjes brenda dhe jashtë vendit. Për shkak të mungesës së përzgjedhjes në vend, është e vështirë të thuhet se cilat janë sasitë e mbetjeve organike, por për shembull në Evropën Lindore, midis 40% dhe 60% e mbetjeve komunale janë organike. Të dhëna të tilla rrisin potencialin për përpunim dhe për krijimin e humusit. Nga ana tjetër, mbetjet komunale të pa seleksionuara përfundojnë në deponi dhe përbëjnë rrezik si burim potencial infeksionesh, ndotjesh dhe zjarresh.

“Ne jemi krenarë për bashkëqytetarët tanë”, thonë nga Shoqata dhe shtojnë se kanë pritur që të jetë e vështirë të bashkëpunohet me banorët dhe shitësit e tregut, por janë befasuar nga interesimi i qytetarëve. “Për mënyrën e re të trajtimit të mbetjeve i kemi informuar individualisht shitësit e tregut të qytetit, si dhe banorët e rastësishëm në treg. Udhëzimet tona u pranuan, me pak përjashtime. Një rezultat i tillë na jep vullnet dhe besim edhe më të fortë për të realizuar ndryshimet në komunën tonë”, thotë Kostadin Karev nga “Changemakers”.

Projekti realizohet në bashkëpunim me NKVK “Komunalec” nga Gjevgjelia, dhe financohet nga Civica mobilitas.



Aksioni i “Megjashi” për mbështetje të familjeve që jetojnë në varfëri



Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, Ambasada e parë e fëmijëve në botë Megjashi nisi pjesën e dytë të aksionit në mbështetje të familjeve që jetojnë në varfëri.

Aksioni i tyre filloi në platformën ECrowd.mk, ku u njoh dhe u përkrah nga një numër i madh i qytetarëve. Njëkohësisht janë siguruar 62.600 denarë për blerje të produkteve ushqimore dhe higjienike. Menjëherë pas përfundimit të aksionit për gjenerimin e mjeteve, përfaqësuesit e Komisionit të letrave me vlerë nga ku mbërritën në donacion me mjete shkollore, magjistari Kristian Shopov përmes dhurimit të një pakoje shtesë me produkte ushqimore dhe higjienike, si dhe të sapomartuarit Despina dhe Sinisha të cilët në dasmën e tyre, ata i inkurajuan mysafirët e tyre që në vend të luleve të dhurojnë mjete shkollore.

Aksionit humanitar i është bashkuar edhe kompania ELS Logistics Service, e cila ka dorëzuar pa pagesë 30 pakot e para për 10 familjet që jetojnë në Kratovë, Kumanovë, Gostivar, Prilep, Shtip, Berovë, Strugë, Manastir, Strumicë dhe Zletovë. Krahas kësaj, magjistari Kristian iu bashkua shpërndarjes së 12 pakove të mbetura në lagjet e Shkupit Lisiçe, Usje, Pintija, Aerodrom, Autokomandë, Fushë Topanë, Shuto Orizarë, Karposh dhe Hrom.

Nga “Megjashi” thonë se edhe pse aksioni i tyre i donacioneve përfundoi me sukses, mbështetja për këto familje të rrezikuara nuk duhet të ndalet. Përkundrazi, është e nevojshme të gjenden zgjidhje afatgjate për kushtet në të cilat gjenden.

Kotelet janë terapia më e mirë

Imagjinoni një kafene ku mund të shijoni shoqërinë e disa koteleve dhe të jeni pjesë e të ashtuquajturave. “kiti terapia”. Interesimi për këtë mundësi u testua nga shoqata “Angelcats” përmes një eksperimenti të vogël social. Pjesëmarrësit në eksperiment mbanin kufje për anulimin e zhurmës dhe për një periudhë të caktuar kohore patën mundësinë të shoqëroheshin dhe të përkëdhelin terapistët kryesorë - kotelet Endi dhe Bella.

Menjëherë pas kësaj eksperience, pjesëmarrësit shprehën efektet pozitive të terapisë me kotele. Sipas tyre, kotelet u kanë dhënë energji pozitive dhe ndihen shumë më të lumtur se kur kanë mbërritur. “Mendoj se Shkupi ka nevojë për një vend të tillë”, tha një nga pjesëmarrëset.



Sipas hulumtimeve të mëparshme, kontakti me kotele ofron shumë përfitime terapeutike për njerëzit, duke përfshirë: shëndet më të mirë të zemrës, ulje të stresit dhe dhimbjes, sistem më të fortë imunitar, reduktim të simptomave të ankthit dhe depresionit, ulje të ndjenjës së vetmisë, etj.

Kafenetë me kotele janë një mundësi e shkëlqyer për adhuruesit e koteleve që të shijojnë një mjedis të relaksuar dhe pa stres. Një përvojë e tillë mund të sjellë dobi të

madhe sidomos për ata që nuk kanë mundësi të mbajnë kotele në shtëpi, dhe nga ana tjetër, një mjedis i tillë lejon që kotelet të shpëtohen nga eutanazia dhe të gjejnë një shtëpi përmes kujdesit, socializimit dhe rikthimit në shtëpi.

Projekti “Përmes aktivizmit qytetar deri te zgjidhjet sistematike për macet e pastreha” është mbështetur nga programi Civica mobilitas.

U shënua 100 vjetori i Ditës ndërkombëtare të kooperativave

Në organizim të Asociacionit të kooperativave bujqësore maqedonase (AKBM), me mbështetjen e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe programit Civica mobilitas, më 2 korrik në f. Mustafino, Sveti Nikollë, u shënua 100-vjetori jubilar i sivjetmë Dita ndërkombëtare e kooperativave me temën “Kooperativat ndërtojnë një botë më të mirë!”.

“Kooperativat janë modeli i vetëm i ndërmarrjeve me parime të pranueshme globalisht që mbështeten në një themel të vlerave të përbashkëta etike,” tha Suzana Dimitrievska, kryetare e AKBM. Ajo shtoi se përvoja ka treguar se si kooperativat janë treguar më rezistente ndaj krizave se mesatarja. “Ato e inkurajojnë pjesëmarrjen ekonomike, luftojnë degradimin mjedisor dhe ndryshimet klimatike, krijojnë vende pune të mira, kontribuojnë në sigurinë ushqimore, ruajnë kapitalin financiar në komunitetet lokale, ndërtojnë zinxhirë vlerash etike dhe, duke përmirësuar kushtet materiale dhe sigurinë e njerëzve, kontribuojnë në paqen pozitive”.

Përveç ceremonisë së hapjes, programi përfshinte një panel diskutimi ku u ndanë rekomandimet për tejkalimin e sfidave në kooperativa; ndërsa në pjesën ekspozuese 20 kooperativa bujqësore i prezantuan dhe promovuan prodhimin e tyre.

Qëllimi i festimit të Ditës ndërkombëtare është rritja e ndërgjegjësimin për kooperativat dhe promovimi i sukseseve dhe idealeve të lëvizjes së solidaritetit ndërkombëtar, efikasitetit ekonomik, barazisë dhe paqes botërore.



Anketa e tretë debutuese kombëtare – Qytetarët presin reforma zgjedhore

Instituti për politikë evropiane - Shkup (IPE) në bashkëpunim me Qendrën për demokraci deliberative nga Universiteti Stanford nga SHBA-ja i prezantoi rezultatet e Anketës së tretë debatuese kombëtare, të cilat më pas u diskutuan me deputetët dhe ekspertët.

Qytetarët i vlerësuan zgjedhjet e mëparshme dhe reformat zgjedhore me notë mesatare dhe rezultatet e anketës tregojnë se është e nevojshme përfshirja e publikut të gjerë në dialogun për reformat zgjedhore. Anketa e debatit kombëtar tregoi se qytetarët presin reforma zgjedhore, por ata mendojnë se ato nuk duhet të ndodhin menjëherë dhe menjëherë para zgjedhjeve.

Deputetët dhe ekspertët që punojnë për çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet e përshëndetën procesin e anketimit dhe informimit të debatit përpara debatit. Ata e theksuan gjithashtu nevojën e rishikimit të edukimit qytetar, në mënyrë që qytetarët të jenë më të informuar për proceset. Në atë mënyrë, sipas tyre, do të rikthehet besimi i qytetarëve në zgjedhje dhe në sistemin zgjedhor.

Përveç edukimit, informimi më i madh për procesin zgjedhor duhet të iniciohet nga Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, i cili duhet dhe ka për obligim të bëjë më shumë sesa vetëm shpalljen e rezultateve zgjedhore.

Anketa e debatit është një formë unike e konsultimit politik që ndërthur teknikat e shqyrtimit të opinionit publik dhe diskutimit publik, për të paraqitur se si do të dukej opinioni publik për një temë të caktuar, nëse qytetarët do të kishin mundësi të njiheshin më shumë me temën. Anketa debutuese i tregon preferencat dhe opinionet e qytetarëve, para dhe pas një njohjeje të detajuar me temën.



93% e diskutimeve në Kuvend zhvillohen pa ose me argumente të dobëta

Në shkallën nga 1 deri në 10, nota për cilësinë e debatit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për gjysmën e parë të vitit 2022 është 5.5. Këtë e ka treguar vëzhgimi i Institutit për demokraci në periudhën janar – qershor 2022. Fokusi ishte në diskutimet lidhur me pikat e rendit të ditës parlamentare që përfshihen në fushën e sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe demokracisë.

Pavarësisht përmirësimit të lehtë krahasuar me periudhën korrik - dhjetor 2021 (5.4), diskutimi në Kuvend nuk merr notën minimale të kërkuar për t'u quajtur debat konstruktiv. Raporti për këtë periudhë tregon një nivel përgjithësisht të ulët të cilësisë së debatit dhe e konfirmon përfundimin se ka vend për përmirësim të dukshëm.

Në përgjithësi, vërehet një përqendrim i nivelit të argumentimit nga të gjithë pjesëmarrësit në diskutimin në Kuvend. Në 51% të diskutimeve të analizuara, folësit nuk kanë pasur argumente, ndërsa në 42% të diskutimeve

të analizuara kanë pasur argumente të dobëta, pra folësit kanë ofruar një shpjegim të qëndrimeve të tyre që nuk mjafton për t'u konsideruar si argument i plotë. Faktet, p.sh. dëshmitë e cituara nga hulumtime, përvoja, dokumente dhe burime të tjera relevante, janë përdorur vetëm në 3% të diskutimeve.

Në këtë periudhë raportuese, deputetët në fjalimet e tyre më shumë iu referuan personalitetit të bashkëbiseduesit nga një opsion tjetër politik, sesa shqyrtimit substancial të argumenteve të tyre. Mirëpo, fjalimet në të cilat deputetët nuk i referohen argumenteve të deputetëve të opsionit tjetër (76%), as personalitetit të tyre (65%), mbizotërojnë dukshëm, që do të thotë se deputetët nuk angazhohen sa duhet në një shkëmbim thelbësor të pikëpamjeve.

Mes dhjetë deputetëve më aktivë, tre janë gra. Pjesëmarrja e grave në diskutimin total është 42% dhe mbetet relativisht në të njëjtin nivel me periudhën korrik - dhjetor 2021, e cila



përfaqëson pjesëmarrjen më të lartë krahasuar me të gjitha periudhat e mëparshme të vëzhgimit. Deputetët Gordana Siljanovska Davkova dhe Bojan Stojanoski ishin ata që folën më së shumti dhe qëndruan më gjatë në foltoren e deputetit.

Raporti e konfirmon gjithashtu vëmendjen e ulët të vazhdueshme të deputetëve ndaj të drejtave të grupeve të marginalizuara, përveç rasteve kur diskutohet në mënyrë specifike një ligj apo pikë në rendin e ditës që lidhet me të drejtat e tyre.

Kultura e debatit të deputetëve në Kuvendin tonë, e mbështetur me argumente të qarta dhe të qëndrueshme që mbështesin drejtpërdrejt qëndrimin e mbrojtur, është në nivel relativisht të ulët. Kjo është arsyeja pse ky raport përfshin disa rekomandime, si dhe mjete në dispozicion të deputetëve për të arritur një nivel më të lartë të cilësisë së debatit.

Është rritur vlera e kontratave të lidhura pa procedurë transparente

Qendra për komunikim civil (QKC) e publikoi Raportin e monitorimit të rregullt të prokurimeve publike të kryera në periudhën korrik-dhjetor 2021, ku përfshihen edhe gjetjet nga anketa e kompanive për përvojën e tyre në pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik, analiza e procedurat pranë Komisionit shtetëror për ankesat e prokurimit publik për vitin 2021 dhe një anketë e autoriteteve kontraktore mbi kapacitetet e tyre të personelit për prokurimin publik.

Sipas gjetjeve të monitorimit të prokurimeve publike është rritur vlera e kontratave të lidhura me negociim pa publikimin e shpalljes. Vlera e përgjithshme e këtyre kontratave në vitin 2021

është 46 milionë euro, që është 16 milionë euro më shumë se në vitin 2020. Rreth 80% e vlerës së kontratave të lidhura pa publikim të shpalljeve i takon SHA Elektranat, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Gjithashtu, duke qenë se janë dorëzuar vetëm një e treta e njoftimeve për kontratat e realizuara, mund të konstatohet se institucionet nuk e respektojnë detyrimin ligjor për shpalljen e tyre publike.

Në anketën e kompanive të realizuar në vitin 2022, kanë marrë pjesë 284 kompani të cilat e vlerësojnë procesin e prokurimit publik në vend me notë mesatare prej 2.8 (në shkallën nga 1 deri në 5), që është e njëjtë me vitin e kaluar. Shumica e të anketuarve besojnë se ka marrëveshje të fshehtë në tenderë dhe korrupsion, por vetëm 6% kanë deklaruar se gjithmonë ose shpesh paraqesin ankesa në Komisionin shtetëror për ankesa të prokurimit publik.

Sa i përket burimeve njerëzore për prokurimin publik në ministri dhe komuna, gjetjet tregojnë se prokurimet në



ministritë realizohen nga një deri në 24 punëtorë, ndërsa në komuna nga një deri në shtatë punëtorë. Disa nga institucionet përdorin edhe asistencën e ekspertëve të jashtëm, pa u kujdesur për të parandaluar konfliktin e mundshëm të interesave.

Sipas Bazës së të dhënave të prokurimeve publike në komuna në vitin 2021, Qyteti i Shkupit dhe 80 komuna kanë shpenzuar 51 milionë euro më shumë se në vitin 2020. Kërcimet më të mëdha të vlerës së prokurimit publik në krahasim me vitin paraprak janë vërejtur në Qytetin e Shkupit nga 15 milionë euro, në Komunën Qendër nga 5,5 milionë euro dhe në Komunën e Gazi Babës nga rreth 5 milionë euro. Rëniët më

të mëdha për nga vlera janë vërejtur në komunën Çučer Sandevë për rreth 630 mijë euro, Karposh 483 mijë euro dhe Aerodrom 475 mijë euro.

Qyteti i Shkupit dhe 80 komuna kanë shpenzuar 51 milionë euro më shumë në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020.

Listën e 10 kompanive të para me vlerën më të lartë të tenderëve nëpër komuna në vitin 2021 e kryeson kompania ndërtimore Zhikol DOOEL eksport import nga Strumica me 21 kontrata të lidhura me vlerë të përgjithshme prej 22 milionë euro.

Programi vjetor i Qendrës për komunikim qytetar mbështetet nga Civica mobilitas.

E drejta për shëndet do të thotë edhe qasje në abortin ligjor



“Një shoqëri e drejtë gjinore në të cilën aborti do të jetë i sigurt, i ligjshëm dhe i aksesueshëm për të gjitha gratë, pa stigma dhe diskriminim” - kjo është kërkesa që mijëra mbështetës të lirisë riprodhuese u dërguan qeverive të tyre në mbarë botën më 28 shtator - Dita ndërkombëtare e abortit të sigurt. Me atë rast, Platforma për barazi gjinore thekson se qasja në shërbimet e shëndetit riprodhues duhet të garantohet, edhe në kohë krize.

Edhe pse ligji ekzistues për ndërprerjen e shtatzënisë në Maqedoninë e Veriut është më liberal se ai i mëparshmi, ai ende nuk parasheh mbulimin e shpenzimeve nëse ky shërbim shëndetësor kërkohej për arsye sociale ose materiale. Duke e trajtuar abortin si shërbim shëndetësor thelbësor vetëm kur ka arsye mjekësore, Fondi për sigurime shëndetësor dhe institucionet e tjera kompetente i vendosin në një situatë të pashpresë gratë që nuk duan të vazhdojnë shtatzëninë dhe që janë në rrezik social ose që jetojnë në varfëri.

Në më pak se një vit çmimet e abortit në spitalet private në Maqedoni janë dyfishuar dhe tani ky shërbim kushton 350-400 euro. Gjithashtu, aborti mjekësor (aborti

medikamentoz), i cili është opsion më i sigurt dhe më i lirë se metoda kirurgjikale, është i disponueshëm vetëm në Klinikën Universitare për Gjinekologji dhe Obstetrikë në Shkup, por jo vazhdimisht për shkak të ndërprerjes së shpërndarjes së barnave të nevojshme. Gratë nga qytetet e tjera, nga ana tjetër, nuk e kanë këtë alternativë jo vetëm për shkak të barnave të padisponueshme, por edhe për shkak të stafit të trajnuar të pamjaftueshëm në spitalet shtetërore lokale.

Prandaj, Platforma për barazi gjinore u bëri thirrje institucioneve kompetente në vend që të njohin nevojën e grave të varfra dhe të marginalizuara për abort dhe të ofrojnë çmime të përballueshme financiarisht për këtë shërbim shëndetësor thelbësor, veçanërisht në kohë krize. Përndryshe, shteti drejtpërdrejt (do) t'i shtyjë gratë në varfëri dhe pasiguri sociale akoma më të madhe dhe nuk përjashtohet që t'i detyrojë ato të kërkojnë alternativa më të lira të paligjshme për abortin, gjë që do të rrezikonte drejtpërdrejt shëndetin e tyre dhe mirëqenien e të afërmeve të tyre.

Familjet e varfra të lëna jashtë masave për uljen e ndotjes

Grupi më i varfër i njerëzve me të ardhura mujore deri në 25.000 denarë në familje janë lënë jashtë masave për uljen e ndotjes, ndërsa personat më të pasur me të ardhura mujore mbi 40.000 denarë janë ndotësit më të mëdhenj sepse këtë e bëjnë me dëshirë, jo për shkak të pamundësisë. Kjo është një nga gjetjet e “Platformës maqedonase kundër varfërisë” në hulumtimin e tyre “Trajtimi i ndotjes

së ajrit duke minimizuar varfërinë energjetike dhe duke promovuar sjellje pro-mjedisore”.

Në hulumtim janë klasifikuar tre profile socio-ekologjike, njëri prej tyre është me të ardhura mujore deri në 20 mijë denarë në familje, i dyti është ndërmjet 25 dhe 40 mijë denarë në familje dhe i treti me të ardhura prej mbi 40 mijë denarë.

Gjithashtu, profili i parë dhe më i varfër përbëhet nga tre nëngrupe të ndryshme: ata që nuk kanë asnjë burim energjie dhe ngrohje me goma, shishe etj., personat që kanë shumë borxhe dhe nuk mund të përdorin vazhdimisht energji, dhe gjithashtu kalojnë në ngrohje duke djegur objekte; si dhe një grup i tretë që kanë të ardhura të ulëta dhe janë të lidhur me sistemin e ngrohjes, por nuk kanë alternativë nëse nuk u mjafton. Këto profile përballen me mungesë zgjedhjeje dhe mundësinë që kanë në dispozicion dhe nuk janë në gjendje të përfitojnë nga masat për uljen e ndotjes. Për ta është më e rëndësishmja që së pari të forcohen socio-ekonomikisht dhe të fitojnë kushtet elementare të jetesës.

Shkupit i mungojnë investimet dhe intervenimet shtetërore dhe lokale, për sistemet e ngrohjes, sistemet e energjisë së gjelbër dhe mundësitë për akses për të gjithë qytetarët

Grupi i dytë me të ardhura mujore familjare nga 25.000 deri në 40.000 denarë nuk është shumë i kursyer apo i vetëdijshëm për mjedisin, por megjithatë janë të kujdesshëm sepse nuk kanë burime të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha kërkesat dhe nevojat. Për ta, subvencionet për eficiencën energjetike të shtëpive kanë rëndësi të madhe.

Profili i tretë me të ardhura familjare mbi 40.000 denarë janë personat që kanë, munden dhe shpenzojnë para dhe energji. Ata janë ndotësit më të mëdhenj sepse kanë zgjedhjen më të madhe për të zgjedhur. Ndër to, është më e rëndësishme të ndikohet në ndryshimin e ndërgjegjësimit në drejtim të përmirësimit të zakoneve përmes fushatave publike apo veprimeve që do të nënkuptonin lehtësimin e procedurës së aksesit.



Si rezultat i hulumtimit, nga Platforma maqedonase kundër varfërisë thonë se ajo që në përgjithësi mungon është zhvillimi i balancuar i qytetit, infrastrukturë më e mirë, punë më e madhe ndërsektoriale dhe investime dhe ndërhyrje shtetërore dhe lokale, para së gjithash në sistemet e ngrohjes, sistemet e energjisë së gjelbër dhe akses ndaj kushteve të barabarta, cilësore dhe dinjitoze të jetesës për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë dhe në solidaritet.

Hulumtimi është realizuar nga ana e MPPS në kuadër të projektit “Trajtimi me ndotjen e ajrit në qytetin e Shkupit”, i financuar nga Suedia, i implementuar nga Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara në partneritet me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Qytetin e Shkupit.

Çfarë i motivon dhunuesit në fusha sportive?

Urrejtja ndaj klubit kundërshtar është shkaku më i zakonshëm i dhunës në terrenet sportive. Këto janë të dhënat që dolën nga hulumtimi i NEXUS – Civic Concept, me titull “Identifikimi i faktorëve që ndikojnë në dhunën në terrenet sportive”.

Pyetja e arsyeve pse ndodh dhuna në ndeshjet sportive tregon se tifozët nuk sillen në mënyrë racionale, por janë të shtyrë në radhë të parë nga emocionet negative.

Gjegjësisht, numri më i madh i të anketuarve, pra 41.7%, janë përgjigjur se dhuna ka qenë e motivuar nga urrejtja ndaj klubit kundërshtar. Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve (19.8%) janë përgjigjur se dhuna ndodh për shkak të përkatësisë etnike dhe fetare të tifozëve/klubit me të cilin ata konkurrojnë. Gjithsej 7.5% e të anketuarve janë përgjigjur se dhuna ndodh për shkak të ndikimit politik, ndërsa vetëm 5.7% e të anketuarve janë përgjigjur se dhuna ndodh për përfitime financiare.



Një numër i madh i të anketuarve janë përgjigjur se ka arsye të tjera, të cilat nuk janë identifikuar në pyetësor, të cilat shkaktojnë sjellje të dhunshme te fansat. Ai tregon nevojën për kërkime të thelluara, shtesë mbi motivet pas sjelljes së dhunshme.

Rezultatet, siç thuhet në Raport, e tregojnë nevojën për ndryshimin e modelit të kulturës së tifozëve në vend, politikat që duhet të zbatohen dhe institucionet për zbatimin e tyre.

Duke marrë parasysh rezultatet e hulumtimit, duhet menduar për tifozët, brohoritjet dhe grupet e tifozëve që duhet të modelohen dhe promovohen dhe ato që duhet të marginalizohen. Një shembull i mirë i kësaj është transformimi i tifozëve në ndeshjet e futbollit në Angli. Tifozët duhet të mbështesin ekipin e tyre, duhet të ketë

një shkallë rivaliteti me klubet e tjera, por nuk duhet të kthehet në urrejtje. Sporti, e sidomos futbollit, nuk duhet të jetë rob i një grupi të vogël huliganësh, të cilët janë të lidhur mirë me njëri-tjetrin dhe shpeshherë me klubin që përkrahin, por duhet hapur për qytetarin e zakonshëm. Në këtë mënyrë, sporti do të ketë një audiencë më të madhe, më shumë vëmendje në media, më shumë financa dhe më shumë zhvillim.

Tejkalimi i sjelljes së dhunshme në ndeshjet sportive, shtohet në Raport, si dhe shmangia e sjelljes së dhunshme në tribuna është parakushti i parë për komercializimin dhe zhvillimin e sportit në tërësi, dhe veçanërisht të futbollit si sporti më popullor në botë, por edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Doracak për krijimin e materialeve didaktike në kushte shtëpiake

Më 20 shtator, Shoqata e personave me aftësi të kufizuara fizike Mobiliteti e promovoi doracakun “Bëje vetë për fëmijën tënd”. Fjala është për një publikim ku prezantohen ushtrime dhe aktivitete praktike për prodhimin e mjeteve ndihmëse didaktike nga materialet e mbeturinave që mund të gjenden në shtëpi.

